

# Gratë dhe Burrat në Shqipëri

**Tiranë, më 12 Shtator 2025:** “Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2025” është një publikim që paraqet të dhëna në fusha të ndryshme të jetës, të ndara sipas gjinisë, me qëllim reflektimin e problematikave të shoqërisë për monitorimin e politikave ndër-sektoriale, në kuadër të arritjes së barazisë gjinore. Statistikat dhe treguesit e prezantuar në këtë publikim u shërbejnë politikëbërësve, botës akademike, shoqërisë civile dhe përdoruesve të ndryshëm për të analizuar në një kontekst të gjerë arritjet e barazisë gjinore.

Publikimi është i konceptuar në kapituj të veçantë, sipas tematikës që mbulohet duke pasqyruar informacion të plotë mbi statistikat gjinore në vendin tonë. Çdo fushë pasqyron dallimet ose pabarazitë e situatës së burrave dhe grave.

## ***Gjetjet kryesore sipas fushave janë:***

### **Popullsia**

- Popullsia banuese në Shqipëri në fund të vitit 2024 përbëhet nga 50,5 % gra dhe 49,5 % burra. Krahasuar me vitin 2023, popullsia e burrave ka rënë me 1,3 % dhe ajo e grave me 1.0 %.
- Shtesa natyrore, gjatë vitit 2024 është pozitive, me 1.060 lindje më shumë se vdekje për gratë dhe vetëm 148 për burrat.
- Raporti gjinor në lindje është 108, që tregon se për çdo 100 vajza të lindura, lindin 108 djem. Ky raport është më i lartë se raporti natyral, i cili është 105.
- Vdekshmëria foshnjore është 5,3 vdekje për një mijë lindje për djemtë dhe 4,1 vdekje për vajzat. Ky tregues ka pësuar rënie, si për djemtë dhe për vajzat, krahasuar me një vit më parë.

### **Shëndetësia dhe abortet**

- Shkakët kryesore të vdekjeve për gratë dhe burrat në vitin 2024, vijojnë të jenë nga “grupsëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut”, të cilat shkaktojnë 54,7 % të vdekjeve tek gratë dhe 51,4 % të vdekjeve tek burrat.
- Nga 23.310 lindje të regjistruara në vitin 2024 shënohen 4.192 aborte, me një raport 180 aborte për çdo 1.000 lindje.
- Raporti i abortit për moshat teke 15 deri 19 vjeç, vlerën më të lartë e shënon moshë 18 vjeç me 179 aborte në 1.000 lindje.
- Pjesa më e madhe e aborteve kryhen nga gratë e grupmoshës 20-34 vjeç, e cila është dhe grupmosha më riprodhuese e gruas.

**Arsimi**

- Në vitin akademik 2023-24, u diplomuan 28.193 studentë, nga të cilët 65,8 % ishin vajza, me një rritje prej 0,6 pikë përqindje, krahasuar me vitin e kaluar akademik.
- Në arsimin 9-vjeçar dhe e mesëm e lartë, gratë përbëjnë shumicën e stafit mësimor, përkatësisht 79,1 % dhe 71,0 %. Në arsimin e lartë, në stafin akademik me kohë të plotë, gratë me titull Profesor përbëjnë 51,4 %, ato me titull Doktor 61,6 % dhe Akademikë dhe Pedagogë pa tituj 59,1 % të totalit për secilën kategori.
- Fushat e studimit ku vajzat diplomohen më shumë janë Biznes, administrim dhe ligj (25,9 %), Shëndet dhe mirëqenie (24,0 %) dhe Shkenca sociale, gazetari dhe informacion (11,9 %). Ndërsa fushat e studimit, ku diplomohen më së shumti djemtë, janë Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim (25,2 %), Biznes administrim dhe ligj (21,6 %), Teknologji e informacionit dhe komunikimit (13,2 %).
- Në popullsinë 25 vjeç e lartë, 52,2 % e grave janë me arsim bazë kundrejt 43,6 % për burrat. Në arsimin e mesëm të lartë, dominojnë burrat (40,3 %, kundrejt 29,0 % të grave), ndërsa në arsimin e lartë, gratë kanë përqindje më të lartë (18,8 % kundrejt 16,1 % të burrave).

**Tregu i punës dhe Mbrojtja Sociale**

- Burrat janë më shumë prezent në tregun e punës sesa gratë, duke pasqyruar pjesëmarrje më aktive, respektivisht 82,3 % dhe 69,3 % për moshat 15-64 vjeç.
- Struktura e të punësuarve sipas statusit të aktivitetit tregon se 51,2 % e grave janë të punësuar me pagë, ndërsa 28,5 % e tyre janë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes.
- Për gratë dhe burrat e moshës 15-64 vjeç mbizotëron punësimi në sektorin e bujqësisë. Në vitin 2024, në sektorin bujqësor janë punësuar 41,5 % gra. Sektori i dytë që zë peshën më të madhe në punësimin e grave dhe burrave është tregti, transport, hoteleri, shërbime të biznesit dhe administrative, përkatësisht me 22,6 % të punësuar gra dhe 28,3 % burra.
- Në vitin 2024, shkalla e papunësisë për burrat në moshën 15-64 vjeç është 8,9 %, kundrejt 10,0 % të grave.
- Shkaqet e inaktivitetit ndryshojnë nga njëra gjini në tjetrën. Ndërkohë që 14,0 % e grave deklarojnë se janë inaktive në tregun e punës, duke përmbyshur detyrat shtëpiake, vetëm 0,4 % e burrave e deklarojnë këtë si shkak inaktiviteti.
- Numri i grave punëkërkuese të papuna në përgjithësi rritet me rritjen e moshës, ndërsa e kundërta ndodh për burrat.
  - Të dhënat tregojnë se rreth gjysma e grave dhe burrave punëkërkuës të papunë kanë arsim 8/9 vjeçar, përkatësisht 46,9 % dhe 44,3 %.
- 48,4 % e përfituesve të pensioneve urbane janë gra. Për përfituesit e pensioneve rurale, raporti gjinor ndryshon ndjeshëm, ku 63,7 % e të siguarve janë gra.
- Hendeku gjinor në paga është 4,9 %. Burrat kanë një pagë mesatare mujore bruto 4,9 % më të lartë sesa gratë. Krahasuar me vitin e mëparshëm, vihet re një ulje e hendekut gjinor në paga me 1,3 pikë përqindje.

### Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale

Në vitin 2024, janë evidentuar nga policia 2.528 gra autore të veprave penale, të cilat përbëjnë 6,3 % të autorëve gjithsej të dyshuar në kryerjen e një veprë penale.

- Nga 40 vrasje me dashje të evidentuara, rreth 22,5 % e tyre kanë ndodhur për shkak të marrëdhënieve familjare (neni 79/c).
- 1.456 gra kanë raportuar dhunë në familje. Qarku i Tiranës ka numrin më të lartë të grave të dëmtuara nga dhuna në familje (41,1 %), ndjekur nga qarku i Durrësit (15,2%) dhe Fierit (8,3 %).
- Janë evidentuar 1.447 të mitur të dëmtuar nga veprat penale, që përbëjnë 8,1 % të personave të dëmtuar gjithsej.
  - 401 janë vajza dhe 1046 janë djem të dëmtuar.
  - Vajzat e dëmtuara nga krimet seksuale përbëjnë 15,5 %.
- Në vitin 2024, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janë 77 gra të burgosura, të cilat përbëjnë 1,7 % të totalit.
  - Shumica e grave të burgosura janë dënuar për krime të lidhura me drogën dhe vrasje.
  - 24,7 % e grave të burgosura kanë arsim të lartë, përkundrajt vetëm 6,1 % të burrave.
  - 22,1 % e grave të burgosura ndjekin kurse të formimit profesional.
- Në burgun e të miturve janë 27 të burgosur, të gjithë djem.

### Gratë në vendimarrje

- Niveli i përfaqësimit të grave në parlament gjatë vitit 2024 është 35,7 %.
- Në zgjedhjet vendore të vitit 2023, në përbërje të listave me kandidatë për kryetar bashkie ishin 10,4 % gra. Kandidatë gra fituese për kryetar bashkie ishin 13,1 %.
- Pjesëmarrja e gruas në misionet diplomatike në vitin 2024 ka qenë në nivele të krahasueshme me burrat, ku përqindja e ambasadorëve gra ishte 37,5 % ndërsa gratë në pozicionin e Ministrit Fuqiptotë ishin 66,7 %.
- Në vitin 2024, përqindja e grave në Forcat e Armatosura është 15,4 %.
- Përqindja e pronareve ose administratoreve gra është më e lartë në ndërmarrjet e vogla (me 1-4 të punësuar) me 32,6 % gra.
- Numri i bizneseve me pronare ose administratore gra është më i madh në Sektorin e Shërbimit, sesa në Sektorin Prodhues, përkatësisht 33,6 % dhe 18,0 %.
- Nga skemat mbështetëse të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve 40,6 % e përfituesve janë gra.

### Tregues social nga Anketat në Familje

- Në vitin 2023, shpenzimet mesatare mujore për konsum për një Njësi Ekonomike Familjare, e përbërë mesatarisht nga 3,7 persona, vlerësohen me 91.675 lekë, që përbën një rritje prej rreth 3,7 %, krahasuar me vitin 2022.

- Gratë, gjatë vitit 2023 kanë kryer më shumë blerje online për veshje/pajisje sportive në krahasim me burrat (55,4 % për gratë dhe 44,6 % për burra), ndërsa burrat treguan një preferencë më të madhe për kompjuter, programe kompjuterike, pajisje kompjuteri, pajisje elektronike (50,2 %, përkundrajt 49,8 % për gratë).
- Treguesi i rrezikut për të qenë i varfër në Shqipëri në vitin 2023 është 19,7 %. Në vitin 2022, ky tregues ishte 20,6 %, duke pësuar një rënie me 0,9 pikë përqindje.

### **Të drejtat e njeriut**

- Gjatë viti 2024, Institucioni i Avokatit të Popullit ka shqyrtuar 1.614 ankesa gjithsej për shkelje të së drejtave.
  - 1.005 ankesa janë paraqitur nga burrat, (62,3 %)
  - 485 ankesa janë paraqitur nga gratë, (30,0 %)
  - 124 janë ankesa për shkelje për grupe të ndryshme interesi ku përfitojnë të dyja gjinitë, (7,7 %).
- Burrat kanë paraqitur më shumë ankesa për shkelje të së drejtës së fëmijës (237 raste ose 23,6 % e totalit të ankesave të paraqitura nga burrat), të drejtës së pronës (190 raste ose 18,9 %), dhe të drejtës për një proces të rregullt ligjor (123 raste ose 12,2 %).
- Gratë kanë paraqitur më shumë ankesa për shkelje të së drejtës së fëmijës (195 raste ose 40,2 % e totalit të ankesave nga gratë), të drejtës për një proces të rregullt ligjor (53 raste ose 10,9 %), dhe të drejtës së pronës (38 raste ose 7,8%).
- Lidhur me të drejtën e personave të privuar nga liria janë trajtuar 155 ankesa të lidhura me të drejtën e personave të privuar nga liria, prej të cilave 147 (94,8 %) janë paraqitur nga burrat dhe 4 (2,6 %) nga gratë. Ky grup përfaqëson 9,6 % të ankesave gjithsej.

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të

INSTAT: [Gratë dhe Burrat në Shqipëri](https://www.instat.gov.al/)

# Metodologji

Aspektet gjinore janë një dimension kyç për të gjithë fushat e statistikave në nivel individual. Statistikat gjinore mbledhen dhe prezantohen të disagreguara sipas gjinisë si klasifikimi primar për të reflektuar çështje gjinore. Të dhënat mbledhen duke marrë parasysh stereotipet dhe faktorë socialë dhe kulturorë të cilët mund të cojnë në trajtime të pabarabarta me bazë gjinore.

**Burimi i të dhënave:** Burimet kryesore të të dhënave janë anketat sociale dhe burimet administrative. Anketat sociale në metodologjinë e tyre synojnë mbledhjen e të dhënave të disagreguara sipas gjinisë. Gjithashtu dhe institucionet, burim të të dhënave administrative në bazë të MoU me INSTAT janë të orientuara drejt mbledhjes së të dhënave të disagreguara sipas gjinisë.

Të dhënat mbi statistikën gjinore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

## Koncepte:

Barazia gjinore përshkruan konceptin sipas të cilit të gjitha qëniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e personalitetit të tyre dhe të bëjnë zgjedhje pa kufizime të vendosura nga stereotipat, rolet e ngurta gjinore apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë se sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave konsiderohen, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Ajo nuk do të thotë se gratë dhe burrat duhet të bëhen njëloj, por se të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse janë lindur femra apo meshkuj.